Këndi i BE-së

Krijimi i Këndit të BE-së është mbështetur nga projekti “Bashkitë për në Evropë”, i financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri.

Qëllimi i Këndit të BE-së është të ofrojë informacion mbi Bashkimin Evropian, institucionet dhe politikat e tij, marrëdhëniet e Shqipërisë me BE-në, si dhe fondet dhe programet e Bashkimit Evropian të vlefshme për bashkitë shqiptare, institucionet vendore dhe qytetarët.

Këndi i BE-së

Këndi i BE-së:

- Ofron informacion të specializuar mbi Bashkimin Evropian, organizimin dhe zhvillimin e tij, si dhe mbi politika të ndryshme si arsimi dhe trajnimi, shoqëria civile, mjedisi, politikat rajonale, zgjerimi, tregu i përbashkët, zhvillimi ekonomik dhe bujqësia.
- Ndihmon qytetarët të kuptojnë aspektet e ndryshme të procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
- Ofron informacion mbi fondet dhe programet e Bashkimit Evropian për bashkitë, organizatat e shoqërisë civile, bizneset, studentët, fermerët, shkollat dhe universitetet.
- Shpjegon strukturat themelore të Bashkimit Evropian për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme.
- Ndihmon studentët universitarë të informohen mbi mundësitë e edukimit në BE, trajnimet dhe programet për të rinjtë.
- Informon median lokale dhe grupet e interesit mbi projektet dhe programet e mbështetura nga Bashkimi Evropian në Shqipëri.

Qytetarët mund të vizitojnë Këndin e BE-së në Bashkinë Has, ku koordinatorët lokalë ofrojnë informacion dhe udhëzime sipas nevojave të tyre.

Këndi i BE-së

Njësia e Integrimit Evropian ka për detyrë:

- Bashkërendimin dhe mbështetjen e strukturave administrative të bashkisë për zbatimin e politikave, legjislacionit, investimeve dhe shërbimeve që lidhen me procesin e Integrimit Evropian.
- Bashkërendimin e strukturave administrative për rritjen e kapacitetit përthithës të asistencës së Bashkimit Evropian.
- Përfaqësimin e bashkisë në marrëdhëniet me strukturat qendrore përgjegjëse për integrimin evropian.
- Vendosjen e kontakteve dhe përfaqësimin e bashkisë pranë donatorëve dhe organizatave ndërkombëtare në kuadër të projekteve të bashkëpunimit.
- Organizimin e protokollit të takimeve të drejtuesve të institucionit me delegacione të huaja dhe përfaqësues të trupit diplomatik.

- Monitorimin e projekteve të përbashkëta në kuadër të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar.
- Informimin periodik të publikut dhe grupeve të interesit mbi procesin e integrimit evropian dhe politikat e Bashkimit Evropian.
- Administrimin dhe publikimin e informacionit mbi BE-në dhe procesin e integrimit në faqen zyrtare të internetit të bashkisë.
- Organizimin e aktiviteteve informuese dhe promovuese mbi programet dhe projektet e Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, Këndi I BE-së ka organizuar aktivitete të ndryshme informuese, kulturore dhe promovuese në kuadër të Ditës së Evropës, si dhe aktivitete të tjera që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi vlerat evropiane, procesin e integrimit dhe programet e Bashkimit Evropian.













Projekte dhe Bashkëpunime

"Establishment of the Coordinated Referral Mechanism for cases of domestic violence in the HAS municipality" UNDP

Kapërcim i Gjelbër- Drejt ekonomisë së gjelbër vendore përmes investimeve intelegjente financuar nga European Union in Albania (European Union IPA/CBC Programme Albania-Kosovo).

“Provision of garbage containers and collection vehicle to enhance capacity for waste management” Japan’s grant assistance for grassroots for human security projects The GGP/Kusanone.

“Përmirësimi i infrastrukturës dixhitale në hapësirat publike në Has” Thirrja WiFi4WB është pjesë e projektit EU4Digital dhe financohet nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria Gjermane.

“Environmental protection, promotion of climate change adaptation and mitigation, and risk prevention and management”1st Call for Proposals IPA III Albania-Kosovo (2021-2027).